



INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
Qendra për Çështjet Europiane dhe të Sigurisë (CESA)

TENDENCAT E KRIMIT në Shqipëri

2012

PËRMBAJTJA

I.	Parathënie	3
II.	Gjetjet kryesore	4
III.	Tendencat e krimit në Shqipëri 2012	6
	III.1. Zbulueshmëria e krimit	6
	III.2. Kur ndodhin krimet?	7
	III.3. Krime kundër jetës	8
	III.4. Kanosjet, plagosja dhe dëmtimet e tjera me dashje	11
	III.5. Vjedhjet	13
	III.6. Dhuna e vjedhjeve	15

Puna kërkimore dhe botimi i këtij raporti u realizua në kuadër të mbështetjes institucionale për IDM nga ana e OSI Think Tank Fund (Fondi për Organizatat Studimore i OSI-t) Budapest - Hungari. Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSI Think Tank Fund

Redaktor përgjegjës
Gjergji VURMO

Këshilltar i lartë
Sotiraq HRONI

Puna kërkimore dhe analiza
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
© 2013 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

I. PARATHËNIE

Në shtator 2012, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) publikoi të dhënat e studimit mbi tendencat e kriminalitetit në Shqipëri për periudhën 2008 - 2011, në kuadër të mbështetjes institucionale të Fondit për Organizata Studimore (Osi Think Tank Fund, Budapest). Puna kërkimore dhe analiza u bazua mbi të dhënat zyrtare të Policisë së Shtetit për këtë periudhë 4-vjeçare.

Synimi i këtij studimi të IDM ishte të krijonte sensibilitetin e duhur tek publiku, institucionet shtetërore, opinion-bërësit dhe aktorët vendim-marrës mbi gjendjen e sigurisë publike në vend si edhe të nxiste përmirësimin e politikave dhe masave institucionale në përgjigje të ritmeve alarmante të kriminalitetit.

Duke pasur parasysh interesin me të cilin u përcoll studimi dhe gjetjet e tij në debatin publik dhe nga rrethet e specializuara të ekspertizës përgjatë tre muajve prej publikimit të të dhënave si edhe duke vlerësuar nevojën për të ofruar në vazhdimësi të dhëna konkrete në kuadër të diskursit institucional për forcimin e kapaciteteve dhe praktikës së zbatimit të ligjit në vend, IDM e vazhdoi këtë iniciativë edhe në vitin 2013 duke analizuar të dhënat zyrtare të Policisë së Shtetit mbi kriminalitetin përgjatë vitit të shkuar (2012).

Raporti “Tendencat e Krimit në Shqipëri 2012” bazohet tek e njëjta përqasje metodologjike dhe fokus si edhe studimi i një viti më parë “PASIGURIA E PARALAJMËRUAR: Tendencat e krimit në Shqipëri 2008 - 2011” (IDM, Shtator 2012) duke analizuar tendencat e kriminalitetit përgjatë 2012 dhe duke i krahasuar me një bazë të gjerë të dhënash për periudhën 2008 - 2012, bazuar në kategorizimin e përdorur nga Policia e Shtetit për veprat penale të regjistruara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim falënderon Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bashkëpunimin në kuadër të kësaj pune kërkimore si edhe për gatishmërinë e treguar për të marrë në konsideratë dhe për të reflektuar mbi gjetjet dhe rekomandimet e propozuara nga stafi i ekspertëve të Institutit.

IDM do të vazhdojë të inkurajojë diskursin e politikave të bazuar mbi të dhëna dhe të ndihmojë reformat institucionale në vend për konsolidimin e sigurisë publike dhe shtetit ligjor nëpërmjet punës kërkimore dhe alternativave për reforma institucionale dhe të politikave.



II. GJETJET KRYESORE

Në vitin 2012 janë evidentuar 14.030 vepra penale ku pjesën dërrmuese të tyre (rreth 96%) e zënë vjedhjet e ndryshme, kanosjet, armëmbajtjet pa leje, plagosjet dhe veprat penale kundër pronës. Mesatarisht, gjatë vitit 2012 në çdo 40 minuta ka ndodhur një krim. Më konkretisht, organet e Policisë së Shtetit kanë evidentuar:



- Vjedhje në çdo 90 minuta
- Plagosje e lehtë me dashje në çdo 6 orë
- Vjedhje banese në çdo 7 orë
- Vjedhje lokal tregëtie në çdo 8 orë
- Dëmtime të tjera me dashje në çdo 8 orë
- Kanosje në çdo 8.5 orë
- Armëmbajtje pa leje në çdo 9.5 orë
- Vjedhje automjeti në çdo 13 orë
- Krime kundër jetës thuajse në çdo 24 orë
- Vjedhje me dhunë ose me armë në çdo 27 orë
- Vrasje e mbetur në tentativa në çdo 36 orë
- Vrasje në çdo 72 orë

Organet e Policisë së Shtetit kanë zbuluar autorët e thuajse 2/3 (ose më saktë 76.8%) të veprave penale të regjistruara vitin e shkuar. Zbulueshmëria më e ulët (midis 26% - 52%) sipas të dhënave zyrtare shënohet në rastet e vjedhjeve dhe shkatërrimit të pronës.

Numri më i lartë i krimeve kundër personit regjistrohet kryesisht në tremujorin e tretë të vitit (periudha Korrik - Shtator). Bëhet fjalë për veprat penale të “Vrasjes”, “Vrasje nga pakujdesia”, “Vrasje e mbetur në tentativa”, “Krime kundër shëndetit”, “Kanosje”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Dëmtime të tjera me dashje”. Krimet kundër pronës dhe vjedhjet e ndryshme shënojnë pikun e tyre në tre mujorin e parë të vitit (periudha Janar - Mars). Të tillë janë rastet e veprave penale si “Vjedhje kompanie / firme”, “Vjedhje banese”, “Vjedhje lokale tregëtie”, “Vjedhje me dhunë”, “Vjedhje me armë

Krime kundër jetës - Vrasje, Vrasje nga pakujdesia dhe Vrasje e mbetur në tentativa - janë në rritje prej vitit 2010. Këto krime kanë kapur një shifër prej 354 veprash të tilla penale në vitin që lamë pas. Krimet kundër jetës kanë shënuar shifrën më të lartë për 3-mujor

II. GJETJET KRYESORE

të pesë viteve të fundit me 111 vepra penale për periudhën Korrik - Shtator 2012. Pjesën më të madhe të kësaj kategorie e zënë veprat penale të “Vrasje e mbetur në tentativë dhe “Vrasje”.

Nga 1027 raste të kanosjeve të regjistruara vitin e shkuar, 1025 prej tyre janë evidentuar si vepër penale “Kanosje” dhe vetëm 2 raste janë kategorizuar si vepër penale “Kanosje serioze për hakmarrje ose gjakmarrje” për të cilën kodi penal parashikon dënime më të ashpra.

Vjedhjet e ndryshme përbëjnë thuhetse 40% të totalit të veprave penale të regjistruara nga organet e Policisë së Shtetit në vitin 2012 dhe njëkohësisht shfaqin shkallën më të ulët të zbulueshmërisë (nga 26% - 52% të rasteve). “Vjedhje banese” dhe “Vjedhje automjeti” kanë shënuar një rritje prej 26% dhe 11% përkatësisht krahasuar me një vit më parë (2011).

“Vjedhjet me armë” dhe “vjedhjet me dhunë” gjithashtu janë në rritje të pandërprerë prej 5 vitesh. Përveç trendit në rritje për këto vepra penale, një tjetër fakt shqetësues përbën edhe shkalla e zbulueshmërisë së tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2012 organet e Policisë së Shtetit kanë zbuluar autorët e rreth 50% të rasteve të vjedhjeve me armë apo vjedhjeve me dhunë

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012

Sipas shifrave zyrtare të Policisë së Shtetit, në vitin 2012 janë evidentuar 14.030 vepra penale çka do të thotë se vitin e shkuar mesatarisht ka ndodhur një krim në çdo 40 minuta. Pjesën dërrmuese të tyre (rreth 96%) e zënë vjedhjet e ndryshme, kanosjet, armëmbajtjet pa leje, plagosjet dhe veprat penale kundër pronës.


III.1. Zbulueshmëria e krimit

Organet e Policisë së Shtetit kanë zbuluar autorët e thuajse 2/3 (ose më saktë 76.8%) të veprave penale të regjistruara vitin e shkuar. Sidoqoftë, kjo e dhënë duhet analizuar më tej me të dhënat e organeve gjyqësore për të evidentuar edhe saktësinë e zbulueshmërisë së krimit nga ana e policisë dhe ndëshkueshmërinë nga gjyqësori. Zbulueshmëria e krimit sipas këtyre të dhënave është në nivele të larta (rreth 93%) për krimet kundër personit, ndërsa për veprat penale kundër pronës policia e shtetit ka zbuluar autorët e rreth 53% të rasteve.

Të dhënat zyrtare të Policisë së Shtetit raportojnë zbulueshmëri 100% të veprave penale (62 në total) si Vrasje nga pakujdesia (10 raste), Krime kundër lirisë së personit (2 raste), Vjedhje e Bankave (3 raste), Vrasje në rrethana të tjera cilësuese (1 rast), Krime seksuale (44 raste), Ushtrim prostitucioni (10 raste) apo Kanosja serioze për hakmarrje ose

gjakmarrje (2 raste). Zbulueshmëria më e ulët (midis 26%-52%) sipas të dhënave zyrtare shënohet në rastet e vjedhjeve e shkatërrimit të pronës. Shih Figurën 1.

Figura 1. Zbulueshmëria më e ulët për veprat penale



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012

III.2. Kur ndodhin krimet?

Analiza e të dhënave evidenton një tjetër tendencë interesante të krimeve që ka të bëjë me kohën kur ndodhin.¹ Më konkretisht, organet e policisë regjistrojnë numrin më të lartë të krimeve kundër personit kryesisht në tremujorin e tretë të vitit (periudha Korrik - Shtator). Bëhet fjalë për veprat penale të “Vrasjes”, “Vrasje nga pakujdesia”, “Vrasje e mbetur në tentativë”, “Krime kundër shëndetit”, “Kanosje”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Dëmtime të tjera me dashje”.

Nga ana tjetër, krimet kundër pronës dhe vjedhjet e ndryshme shënojnë pikun e tyre në tremujorin e parë të vitit (periudha Janar - Mars). Të tillë janë rastet e veprave penale si “Vjedhje kompanie / firme”, “Vjedhje banese”, “Vjedhje lokale tregtie”, “Vjedhje me dhunë”, “Vjedhje me armë”. Veprat penale të kultivimit të bimëve narkotike dhe vjedhja e automjeteve që lidhen me rrethana specifike (si rritja e numrit të automjeteve në qarkullim me kthimin e emigrantëve) janë evidentuar më shumë në tremujorin e tretë të vitit 2012. Në figurën e mëposhtme paraqen këto tendenca për disa prej krimeve.

Figura 2. Piku i krimit - “Kalendari 2012”

Janar - Mars	Prill - Qershor	Korrik - Shtator	Tetor - Dhjetor
Vjedhje e Bankave	Vjedhje të tjera	Vrasje	Vrasje nga pakujdesia
Vjedhje me dhunë	Kundërshtim i policisë	Vrasje e në tentativë	Krime seksuale
Vjedhje me armë		Krime kundër shëndetit	Ushtrim prostitucioni
Vjedhje kompanie		Vjedhje me pasojë vdekje	Të tjera
Vjedhje banese		Shkatërrim i pronës	
Vjedhje lokale tregëtie		Vjedhja e automjeteve	
Armëmbajtje pa leje		Kanosja	
		Plagosje e lehtë me dashje	
		Dëmtime të tjera me dashje	

Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

1. Analiza i referohet numrit të veprave penale për secilin tre-mujor i cili është më i lartë se mesatarja vjetore për tre-mujor për atë vepër penale.

III.

TENDENCAT E KRIMIT
NË SHQIPËRI 2012

III.3. Krime kundër jetës




Janë evidentuar gjatë vitit 2012:

- Krime kundër jetës thujse në çdo 24 orë
- Vrasje në çdo 72 orë
- Vrasje e mbetur në tentativa në çdo 36 orë
- Armëmbajtje pa leje në çdo 9.5 orë
- Kanosje në çdo 8.5 orë
- Dëmtime të tjera me dashje në çdo 8 orë
- Plagosje e lehtë me dashje në çdo 6 orë

Krimet kundër jetës - Vrasje, Vrasje nga pakujdesia dhe Vrasje e mbetur në tentativë - janë në rritje prej vitit 2010. Këto krime kanë kapur një shifër prej 354 veprash të tilla penale në vitin që lamë pas (2012), thujse një rast për çdo ditë. Krimet kundër jetës kanë shënuar shifrën më të lartë për 3-mujor të pesë viteve të fundit me 111 vepra penale për periudhën Korrik - Shtator 2012. Figurat e mëposhtme paraqesin numrin e këtyre veprave penale sipas tremujorëve për vitin 2012 si edhe mesataren për tremujor në 5 vitet e fundit.


Figura 3. Krime kundër jetës 2010



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012


Figura 4. Krime kundër jetës 2008 - 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012). Kategoria e “Krime kundër jetës” përfshin veprat penale të “Vrasje”, “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Vrasje e mbetur në tentativë”.

Pjesën më të madhe të kësaj kategorie e zënë veprat penale të “Vrasje e mbetur në tentativë” (220 krime apo mesatarisht një rast në çdo 36 orë) dhe “Vrasje” (124 krime, ose një rast në çdo tre ditë). Ndërsa shkalla e zbulueshmërisë për “Krimet kundër jetës” në përgjithësi për vitin 2012 ka qenë në nivelin e 91%, organet e Policisë së Shtetit kanë zbardhur rreth 85% të rasteve të veprës penale “Vrasje”.²

Figura 5. Numri i Vrasjeve për 100.000 banorë



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

2. Të dhënat zyrtare të Policisë së Shtetit i referohen veprës penale “Vrasje” dhe jo numrit të viktimave.


III.

TENDENCAT E KRIMIT
NË SHQIPËRI 2012

Vepra penale e “Vrasjes” ka mbetur përgjatë vitit 2012 në të njëjtat ritme të larta si edhe një vit më parë, mesatarisht 31 vepra penale për 3-mujor. Prej vitit 2010 e në vazhdim Shqipëria shfaq shifrat më të larta të kësaj vepre penale në rajon, duke arritur pikën më të lartë në 2 vitet e fundit me rreth 4.4 vepra penale “Vrasje” për 100.000 banorë.³

Rastet e procedimit penal për armëmbajtje pa leje gjithashtu vazhdojnë të shënojnë rritje. Sipas të dhënave të Policisë së Shtetit zbulueshmëria e kësaj vepre penale është në nivelet e 92% të rasteve ndërkohë që për ndëshkueshmërinë e kësaj vepre penale dhe efektet tek parandalimi i krimit në përgjithësi është e nevojshme që këto të dhëna të krahasohen me bazën e të dhënave të gjyqësorit (vendimet e formës së prerë për këtë vepër penale). Figura 6 paraqet trendin e krimit “Armëmbajtje pa leje” në 5 vitet e fundit.

Figura 6. Armëmbajtje pa leje 2008 - 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)


3. CPërlllogaritur në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2011 sipas së cilit numri i popullsisë rezidente në Shqipëri është 2.821.977 banorë. Burimi: INSTAT në <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012

III.4. Kanosjet, plagosja dhe dëmtimet e tjera me dashje

Të dhënat e Policisë së Shtetit në lidhje me “kanosjet” e evidentuara përgjatë vitit 2012 nxjerrin në pah një element të veçantë për sa i përket kategorizimit të veprës penale. Më konkretisht, nga 1027 raste të kanosjeve të regjistruara vitin e kaluar, 1025 prej tyre janë evidentuar si veprë penale “Kanosje” dhe vetëm 2 raste janë kategorizuar si veprë penale “Kanosje serioze për hakmarrje ose gjakmarrje”, për të cilën Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon dënime më të ashpra. Mesatarisht në vitin 2012 janë evidentuar 256 vepra penale të “Kanosjes” ku 3-mujori i tretë shënon numrin më të lartë (me 311 raste).

Figura 7: ‘Kanosja’ sipas tremujorëve 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)


Nga të dhënat e mësipërme (Figura 7) rezulton se mesatarisht gjatë vitit të shkuar në çdo 8.5 orë të paktën një qytetar është kanosur. E njëjta mesatare rezulton edhe për veprën penale të “Dëmtime të tjera me dashje” për të cilën sipas të dhënave të Policisë së Shtetit gjatë vitit të shkuar janë regjistruar 1061 raste ose mesatarisht 265 vepra të tilla penale për çdo 3-mujor.

III.

TENDENCAT E KRIMIT
NË SHQIPËRI 2012

Vepra penale “Plagosje e lehtë me dashje” shfaqet akoma më serioze, duke vazhduar në këtë mënyrë tendencën e tre viteve të fundit. Më konkretisht, sipas të dhënave zyrtare për vitin 2012 në çdo 6 orë të paktën një qytetar ka qenë pre e një vepre penale “Plagosje e lehtë me dashje. Referuar studimit të IDM “PASIGURIA E PARALAJMËRUAR: Tendencat e krimit në Shqipëri 2008 - 2011” (Shtator 2012) mbi të dhënat zyrtare të kriminalitetit, kjo vepër penale vazhdon të ruajë tendencën rritëse duke shënuar gjatë vitit të shkuar numrin më të lartë të 5 viteve të fundit - 1375 raste të evidentuara. Figura e mëposhtme jep një vizualizim të kësaj tendence pesë vjeçare.

Figura 8. Plagosje e lehtë me dashje. Të dhënat për tremujor 2008-2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012

III.5. Vjedhjet

Vjedhjet e ndryshme përbëjnë thuajse 40% të totalit të veprave penale të regjistruara nga organet e Policisë së Shtetit në vitin 2012 dhe njëkohësisht shfaqin shkallën më të ulët të zbulueshmërisë (nga 26% - 52% të rasteve). Më konkretisht, janë rreth 5500 raste vjedhjesh kompanie/firme, banese, automjeti, lokal tregëtie e vjedhje të tjera të evidentuara vitin e shkuar çka do të thotë se gjatë vitit 2012 mesatarisht në çdo 90 minuta ka ndodhur 1 vjedhje e evidentuar nga organet e Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2012:

- Në çdo 90 minuta regjistrohet një vjedhje
- Në çdo 7 orë është vjedhur një banesë
- Në çdo 8 orë është vjedhur një lokal tregëtie
- Në çdo 13 orë është vjedhur një automjet
- Në çdo 27 orë ndodh një vjedhje me dhunë ose me armë

* 55% është shkalla e zbulueshmërisë e “Vjedhjeve”


Përgjithësisht, numri më i lartë i vjedhjeve regjistrohet në tre mujorin e parë të vitit (Janar - Mars). Në rastin e “vjedhjeve kompanie/firme” dhe “vjedhje lokali tregëtie” përveç tre mujorit të parë edhe periudha Tetor - Dhjetor shfaqet problematike, ku në total vërehet se rreth 60% e këtyre veprave penale ndodhin pikërisht në këta dy tre-mujorë. Ashtu si edhe në periudhën 2008 - 2011 vepra penale e “Vjedhje lokali tregëtie” shënon rënie në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit. Tendanca në rritje e kësaj vepre penale konfirmohet edhe në vitin e shkuar ku në vitin 2012 janë evidentuar 1034 raste, ose 25% më shumë se në vitin 2011. Vepra penale e “Vjedhje kompanie/firme” është evidentuar nga Policia e Shtetit në 261 raste gjatë vitit 2012.



III.

TENDENCAT E KRIMIT
NË SHQIPËRI 2012


Figura 9. Veprat penale “Vjedhje kompanie / firme” dhe “Vjedhje lokal tregtie” 2008 - 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

Dy vepra penale të cilat gjithashtu shfaqin një kurbë thuajse identike në pesë vitet e fundit janë “Vjedhje banese” dhe “Vjedhje automjeti”. Siç shihet edhe nga figura më poshtë, të dy këto vepra penale kanë shënuar një rritje prej 11% për vjedhjet e automjeteve dhe 26% për vjedhjet e banesave krahasuar me një vit më parë (2011).

Figura 10. Trendi 5-vjeçar i “Vjedhje banese” & “Vjedhje automjeti”




Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)

III. TENDENCAT E KRIMIT NË SHQIPËRI 2012

Ashtu siç u evidentua edhe një vit më parë nga studimi i IDM “PASIGURIA E PARALAJMËRUAR: Tendencat e krimit në Shqipëri 2008 - 2011”, kategoria e veprave penale “Vjedhje të tjera” vazhdon të shfaqë tendenca rritëse (vija e kuqe në figurën më poshtë). Gjatë vitit të shkuar Policia e Shtetit ka regjistruar 298 vepra të tilla penale më shumë sesa në vitin 2011”.

Figura 11. Numri i veprave penale “Vjedhje të tjera” 2008 - 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)


III.6. Dhuna e Vjedhjeve

“Vjedhjet me armë” dhe “vjedhjet me dhunë” gjithashtu janë 2 vepra të tjera penale në rritje të pandërprerë prej 5 vitesh ndërkohë që “vjedhjet me pasojë vdekjen” gjatë vitit 2012 kanë mbetur thuajse në të njëjtat nivele (4 raste në total). Përveç trendit në rritje për 2 veprat e para penale, një tjetër fakt shqetësues përbën edhe shkalla e zbulueshmërisë së tyre. Më konkretisht gjatë vitit 2012 organet e Policisë së Shtetit kanë zbuluar autorët e rreth 50% të rasteve të vjedhjeve me armë dhe po aq për rastet e vjedhjeve me dhunë. Figura 12 jep një pamje grafike të tendencës së këtyre dy krimeve të cilat rezultojnë të dyfishuara vitin e shkuar krahasuar me 5 vite më parë (2008).

III.

TENDENCAT E KRIMIT
NË SHQIPËRI 2012

Figura 12. “Vjedhjet me armë” dhe “vjedhjet me dhunë” 2008 - 2012



Burimi: Të dhëna zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (2012)